| 16 Valbona Halil Brasha | e ve | 2 | 1+1 | 82.1 | 7000 | 11000 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 17 Rezarta Dilaver Kushi | PAK, e divorcuar | 3 | 1+1 | 166.2 | 10000 | 2160 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 10000 | 3000 | 7000 |
| 18 Jorgo Dilaver Kurti | ndihme ekonomike, kom egjiptian | 2 | 1+1 | 70 | 7500 | 3000 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 7500 | 2250 | 5250 |
| 19 Ramazan Isuf Brajha | emergjencat civile | 2 | 1+1 | 20 | 10000 | 0 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 10000 | 3000 | 7000 |
| 20 Arjana Hysen Novaku | ndihme ekonomike | 4 | 2+1 | 38 | 8500 | 4860 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 8500 | 2550 | 5950 |
| 21 Rrushe Osman Hunci | PAK | 1 | 1+1 | 40 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 22 Skender Shefqet Tanushi | invalid pune | 2 | 1+1 | 68 | 7000 | 19000 | te ardhura te ulta | 15% | 1050 | 5950 | 1785 | 4165 |
| 23 Besnik Hekuran Kurti | kom egjiptian, ndihme ekonomike | 5 | 3+1 | 30 | 9000 | 5760 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 24 Viturie Rexhep Doskja | e ve, ndihme ekonomike | 3 | 2+1 | 40 | 10000 | 3600 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 10000 | 3000 | 7000 |
| 25 Blerina Qamil Dobrenji | e divorcuar | 2 | 1+1 | 52.1 | 9000 | 39000 | te ardhura te ulta | 15% | 1350 | 7650 | 2295 | 5355 |
| 26 Ferdinand Petrit Kurti | kom egjiptian, emergjencat civile | 4 | 2+1 | 141.4 | 9500 | 0 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 9500 | 2850 | 6650 |

| | | | | | | | | | | | | | |
|----|------------------------|---------------------------------------|---|-----|-------|-------|-------|--------------------------|-----|------|-------|------|------|
| 27 | Luljana Nuredin Brahja | e ve,kom egiptian, emergjencia civile | 4 | 2+1 | 30 | 10000 | 2480 | Pa te ardhura | 0% | 0 | 10000 | 3000 | 7000 |
| 28 | Ali Gani Brahja | kom egiptian, emergjencia civile | 6 | 3+1 | 30 | 9000 | 7280 | te ardhura shume te ulta | 15% | 1350 | 7650 | 2295 | 5355 |
| 29 | Imer Korp Sula | te moshuar,pension | 2 | 1+1 | 45 | 7000 | 11000 | pa te ardhura | 0 | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 30 | Albina Kurti | E ve | 3 | 1+1 | 68 | 9000 | 10000 | pa te ardhura | 0 | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 31 | Lulzime Tahiri (Roci) | ne proces divorci | 3 | 1+1 | 41.58 | 10000 | 11642 | te ardhura shume te ulta | 15% | 1500 | 8500 | 2550 | 5950 |
| 32 | Valentina Hoxha | Nd. ekonomike, ne proces divorci | 4 | 2+1 | 40 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 33 | Eliverda Balliu | kryefamiljare, e divorcuar | 3 | 2+1 | 154.7 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 34 | Jonida Hunei | , kryefamiljare,e divorcuar | 2 | G | 45.5 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 35 | Fatmir Kurti | invalid pune dhe PAK | 2 | 1+1 | 117.1 | 8000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 8000 | 2400 | 5600 |
| 36 | Nadire Cepi | kryefamiljare, e divorcuar | 4 | 2+1 | 86.8 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 37 | Kasem Jugu | Kom. Egiptian | 2 | 1+1 | 60.54 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 38 | Luan Rrupli | nd. Ekonomike | 4 | 2+1 | 113.3 | 10000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 10000 | 3000 | 7000 |
| 39 | Dritan Brahja | Nd. Ekonomike, divorcuar | 1 | 1+1 | 26.6 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 40 | Osman Cota | PAK | 4 | 2+1 | 86.5 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 41 | Hasan Shehu | Te moshuar | 2 | 2+1 | 40 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 42 | Dilaver Koxha | Pak | 4 | 1+1 | 60 | 8000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 8000 | 2400 | 5600 |
| 43 | Eduard Zylali | komuniteti egiptian,ndihme ekonomike | 5 | 1+1 | 62.4 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 44 | Xhemal Beneri | te moshuar | 2 | 1+1 | 60 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 45 | Lirije Sula | , e ve, e moshuar, | 1 | 2+1 | 83.2 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 46 | Luljeta Dokuzi | proces divorci,pak | 3 | 2+1 | 91 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 47 | Rexhep Korra | kemp, ndihme ekonomike | 3 | 2+1 | 88 | 7500 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7500 | 2250 | 5250 |
| 48 | Drita Rrupli | e ve,emergjencia civile | 4 | 2+1 | 110 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 49 | Vangjel Kovaci | I moshuar, I braktisur | 1 | 1+1 | 100 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 50 | Mexhit Deda | I moshuar,e verber | 2 | 1+1 | 75 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 51 | Qamile Brahja | k.egjiptian, e moshuar,emergjencat | 1 | 1+1 | 60 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 52 | Xhevit Murati | te moshuar | 2 | G | 25 | 7000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7000 | 2100 | 4900 |
| 53 | Ymer Daja | te moshuar | 2 | 1+1 | 67 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 54 | Arben Alcani | emergjencat | 3 | 2+1 | 82.3 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 55 | Adelina Shkalla | e divorcuar, ndihme ekonomike | 3 | 1+1 | 47 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 56 | Sokrat Bloku | PAK,ndihme ekonomike, | 5 | 2+1 | 78 | 9000 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 9000 | 2700 | 6300 |
| 57 | Skenderie Xhabli | PAK,ndihme ekonomike, | 2 | 1+1 | 68 | 7500 | 0 | pa te ardhura | 0% | 0 | 7500 | 2250 | 5250 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

9/ Vendi/ku
7/07

PROJEKT-VENDIM

Nr _____ Datë ____ / ____ /2024

Për miratimin e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit , bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij;

Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;

Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

Vendosi

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd ”**, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.,sipas draftit bashkangjitur.
2. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHDI

KRYETARI

Nr. _____ Prot

Librazhd më / / 2024

Relacion

Mbi miratimin e kontratës së **“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasan midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. midis Bashkisë Librazhd dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshillit Bashkiak Ketu

Siç jeni në dijeni, shoqëria “ECO-ELB” sh.a. është krijuar si shoqëri publike me kapital të përbashkët të të gjithë bashkive të Qarkut Elbasan, dhe ka si objekt trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Librazhdit”

Pas vendimin nr. 484, datë 13.12.2021 të Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për vendosje të sekuestros konservative për shoqërinë “Albtek Energy” sh.p.k., ky impjant është vënë në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, deri në përfundimin e procesit dhe marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata. Me kontratën e qirasë nr. 548, datë 21.02.2022, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i ka dhënë shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., kundrejt qirasë prej 1 (një) Euro në muaj (bruto), Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit” në tërësinë e tij, me qëllim vënien në funksion dhe përpunimin e mbetjeve urbane të të shtatë bashkive të Qarkut Elbasan.

Në këto kushte, bazuar në nenet 9 e 11 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, secila nga bashkitë e Qarkut, përfshirë edhe Bashkinë Librazhd, do të lidhin me shoqërinë publike “ECO-ELB” sh.a., **kontratën e “Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Librazhd”** në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Kjo kontratë rregullon modalitetet e pranimit, trajtimit dhe përpunimit të mbetjeve, tarifën e përpunimit për ton e cila është përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme në vendim dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e paleve në lidhje me këtë proces.

Për sa mësipër, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 22 e 54 të tij, ju propozojmë miratimin e draft-kontratës bashkangjitur këtij relacioni.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj!

Konceptoi : Sekretar i Pergjithshem
Bajram Pishkashi

Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”

Email: info@bashkialibrazhd.gov.al

www.bashkialibrazhd.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

PROJEKT-VENDIM

Nr _____ Datë ____ / ____ /2024

Miratimin e marrëveshjes për *“Ndërtimin dhe pajisjen e objektit Ambulancë tip T-1 në qytetin Librazhd ”* midis Bashkisë Librazhd dhe Fondacionit “Mirësia”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit , bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54 të tij:

Vendosi

1. Të miratojë lidhjen e marrëveshjes për *“Ndërtimin dhe pajisjen e objektit Ambulancë tip T-1 në qytetin Librazhd ”* midis Bashkisë Librazhd dhe fondacionit “Mirësia” sipas marrëveshjes bashkangjitur;
2. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi;
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË
MARIGLEN DISHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Librazhd më / / 2024

Relacion

Të miratojë lidhjen e marrëveshjes për **“Ndërtimin dhe pajisjen e objektit Ambulancë tip T-1 në qytetin Librazhd”** midis Bashkisë Librazhd dhe fondacionit “Mirësia” sipas marrëveshjes bashkangjitur;

**Këshillit Bashkiak
Ketu**

Objekti i kësaj marrëveshje është bashkepunimi efektiv, përcaktimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive përkatëse për zbatimin e kësaj marrëveshje bashkepunimi për ndërtimin dhe pajisjen e objektit Ambulancë tip T-1 në qytetin Librazhd, sipas standarteve, projektit e preventivit përkatës.

Sipas kërkesës së donatorit të sigurojë e miratojë:

- a) Dokumentat ligjore për truallin në pronësi të Njësise Administrative ku do të ndërtohet objekti.
- b) Lejen e zhvillimit të sheshit dhe të ndërtimit të objektit
- c) Dokumentat për pikat e lidhjes me ujë, energji elektrike dhe kanalizime.

Te marrë persiper, të përgjigjet e të zgjidh çdo mosmarrëveshje me të tretet për truallin e ndërtimit ose çështje të tjera që lidhen me kompetencat e Bashkisë.

Te jete present në piketimin e objektit dhe të nënshkruaj procesverbalin e piketimit së bashku me palet e tjera të kësaj kontrate dhe firmen ndërtuese.

Te nënshkruaj dokumentat për dhurimin e objektit në cilësinë e palet së interesuar përfaqësuese e komunitetit në nevojë.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj!

Konceptoi : Sekretar i Përgjithshëm
Bajram Pishkashi

Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”

Email: info@bashkialibrazhd.gov.al

www.bashkialibrazhd.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Librazhd më / / 2024

Relacion

Të miratojë lidhjen e marrëveshjes për **“Ndërtimin dhe pajisjen e objektit Ambulancë tip T-1 në qytetin Librazhd”** midis Bashkisë Librazhd dhe fondacionit “Mirësia” sipas marrëveshjes bashkangjitur;

**Këshillit Bashkiak
Ketu**

Objekti I kesaj marreveshje eshte bashkepunimi efektiv, percaktimi i te drejtave.detyrimeve dhe pergjegjesive perkatese per zbatimin e kesaj marreveshje bashkepunimi per ndertimin dhe paisjen e objektit Ambulance tip.T-1 ne qytetin Librazhd ,sipas standarteve.projektit e preventivit perkates.

Sipas kerkeses se donatorit te siguroje e miratoje:

- Dokumentat ligjore per truallin ne pronesi te Njesise Administrative ku do te ndertohe objekt.
- Lejen e zhvillimit te sheshit dhe te ndertimit te objektit
- Dokumentat per pikat e lidhjes me uje,energji elektrike dhe kanalizime.

Te marre persiper,te pergjigjet e te zgjidh cdo mosmarrveshje me te tretet per truallin e ndertimit ose çeshtje te tjera qe lidhen me kompetencat e Bashkise.

Te jete present ne piketimin e objektit dhe te nenshkruaj procesverbalin e piketimit se bashku me palet e tjera te kesaj kontrate dhe firmen ndertuese.

Te nenshkruaj dokumentat per dhurimin e objektit ne cilesine e pales se interesuar perfaqesuese e komunitetit ne nevoje.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj!

Konceptoi : Sekretar i Pergjithshem
Bajram Pishkashi


Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”

Email: info@bashkialibrazhd.gov.al

www.bashkialibrazhd.gov.al

MARREVESHJE

Pale e Interesuar
Bashkia Librazhd
Kryetari
~~Mariglen Disha~~



Donatori
Fondacioni MIREZIA
Drejtori
Korab Kaja



Sot me datë 19/12/2024 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet:

1. Fondacioni "Miresia" me adrese, ne : Rruga Bashkim Shkurti Mezez Tirane;
2. Bashkia Librazhd e perfaqesuar nga kryetari i saj Z.Mariglen Disha ne vijim pale e interesuar.

NENI 1 PALET

1.1 Palet nenshkruese te kesaj Marreveshje Bashkepunimi perfaqesohen nga:

1-Fondacioni "Miresia" me adrese ne Tirane e perfaqesuar nga Drejtori I saj z.Korab Kaja ne vijim Donatori respektivisht Dhuruesi I objektit.

2-Bashkia Librazhd e perfaqesuar nga Kryetari I saj Z.Mariglen Disha ne vijim pale e interesuar.

NENI 2 OBJEKTI

2.1 Objekti I kesaj marreveshje eshte bashkepunimi efektiv,perreaktimi I te drejtave,detyrimeve dhe pergjegjesive perkatese per zbatimin e kesaj marreveshje bashkepunimi per ndertimin dhe paisjen e objektit Ambulance tip.T-1 ne qytetin Librazhd ,sipas standarteve,projektit e preventivit perkates.

A handwritten signature in black ink, which appears to be 'Mariglen Disha', written over several diagonal lines.

A handwritten signature in black ink, which appears to be 'Korab Kaja', written in a cursive style.

NENI 3
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE


Te drejtat dhe detyrimet e Donatorit jane:

- 3.1 Te siguroje, realizoje dhe levroje donacionin per ndertimin dhe pajisjen e objekteve sipas projektit, preventivit e situacioneve perkatese.
- 3.2 Te siguroje projektet e preventivat e punimeve te objektit e t'ja dorezoj paleve perkatese kompetente per dhenien e lejes se zhvillimit.
- 3.3 Te lidhe kontraten e sipermarrjes (ndertimit) dhe kontraten e furnizimit me pajisje dhe aparatura me kompanite specializuara ne fushat perkatese.
- 3.4 Te ndjeke me rigorozitet dhe efektivitet zbatimin e kontratave te lidhura me subjektet e percaktuara sipas ligjeve ne fuqi.
- 3.5 Te marre masat e nevojshme per perfundimin e objekteve ne afat me cilesi e standarte bashkekohore.
- 3.6 Mbikqyrja e punimeve dhe hartimi I dokumentacionit identifikues sipas fazave dhe llojit te ndertimeve, supervizioni I punimeve dhe marrja ne dorezimin e tyre te trajtohen dhe percaktohen me hollesi ne kontraten e sipermarrjes.
- 3.7 Pas perfundimit t'i dhuroje me kontrate ligjore objektet perfituese te donacionit respektivisht pranuesve.

NENI 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PERFITUESIT TE DONACIONIT

- 4.1 Te pranoje donacionin e nevojshem me destinacion per ndertimin dhe pajisjen e ambulances ne Bashkine Librazhd duke hartuar e pergatitur dokumentacionin e duhur ligjor per truallin, lejen e sheshit te ndertimit ne qytetin e Librazhdit.
- 4.2 Te bashkerendoj punen me Njesine Administrative dhe organet shendetesore te saj per hartimin e dokumentacionit teknik e ligjor.
- 4.3 Te ndihmoje e koordinoje punen e tyre per mbarevajtjen e punimeve pa pagesa.
- 4.4 Te administroje me pergjegjesi e korrektesi objektet e Dhuruara, te caktoje paguaj personelin e nevojshem si pjese perberese e qendres Shendetesore.



4.5 Merr persiper regjistrimin e prones ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme duke marre edhe dokumentin perkates te pronesise.

NENI 5

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALES SE INTERESUAR

5.1 Sipas kerkeses se pranuesit te Donacionit te siguroje e miratoje:

- a) Dokumentat ligjore per truallin ne pronesi te Njesise Administrative ku do te ndertohet objekti.
- b) Lejen e zhvillimit te sheshit dhe te ndertimit te objektit
- c) Dokumentat per pikat e lidhjes me uje.energji elektrike dhe kanalizime.

5.2 Te marre persiper,te pergjigjet ,e te zgjidh cdo mosmarrveshje me te tretet per truallin e ndertimit ose çeshtje te tjera qe lidhen me kompetencat e Bashkise.

5.3 Te jete present ne piketimin e objektit dhe te nenshkruaj procesverbalin e piketimit se bashku me palet e tjera te kesaj kontrate dhe firmen ndertuese.

5.4 Te nenshkruaj dokumentat per dhurimin e objektit ne cilesine e pales se interesuar perfaqesuese e komunitetit ne nevoje.

NENI 6

DETYRIME TE PERBASHKETA

6.1 Te bashkepunojne per ndertimin dhe pajisjen e ambulancave me cilesi e ne afatet e percaktura.

6.2 Te bashkerendojne veprimtarine per pergatitjen e dokumentave (dosjes) per dhurimin dhe pranimin e Dhurimit.

6.3 Ne bashkepunim korrekt oraganizojne ceremonine e inagurimit te objektit ku nenshkruhet edhe kontratae Dhurimit te tij.

NENI 7

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

7.1 Kjo marreveshje bashkepunimi hartohet me vullnetin e lire te paleve ne kete ekzemplare te njejte e te barazvlefshem ne gjuhën shqipe ,nga nje per secilen pale nenshkruese te saj dhe nje depozitohet ne Ministrine e Shendetesise bashke me dosjen e plote te dokumentacionit te Dhurimit te objektit.

**PALE E INTERESUAR
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI
MARIGLEN DISHA**



**DONATORI
FONDACIONI MIREZIA
DREJTORI
KORAB KAJA**





→/vendimi
MOP



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZH
KRYETARI**

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ dt. ____ . ____ .2024

**“MBI NDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E VITEVE TË PARA TË ARSIMIT
PROFESIONAL PER VITIN SHKOLLOR 2024-2025”**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenin 30 ‘Funksionet dhe kompetencat e deleguara’, nenin 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, në V.K.M. nr. 666dt.10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe percaktimin e kriterëve për perfitimin e bursave e te pagesave për nxënësit e Arsimit Parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2024-2025” si dhe në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, nr5169 Prot. dt. 24/10/2024 “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të Arsimit profesional për vitin mësimor 2024-2025”. I propozoj Këshillit Bashkiak në mbledhjen e tij të radhes të;

VENDOSI:

I. Të miratojë burse të plotë për nxënësit sipas listës së mëposhtme:

1. Besjana Naim Luka: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Hysen Çela” Durrës, Dega “Hoteleri-Turizëm”
2. Emiljano Migjen Biçaku: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës. Dega “Elekriçist”
3. Arjel Arjan Çoku: Nxënës në Shollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës. Dega “SHMT”
4. Erald Ilir Tusku: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, Dega Termohidraulik.
5. Nardi Myslim Balla: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durrës, Dega “SHMT”
6. Endri Rexhep Karaj: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela Durrës, Dega “SHMT”
7. Orineld Haxhi Sula: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Gjergj Cano” Tiranë, Dega Elektroteknik.
8. Hermes Urim Biçaku: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Charles Teleford Erickson”, Dega “Veterinari.” Golem-Kavajë
9. Martin Leonard Bitroshi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale “Elbasan”. Dega SHMT.”

10. Rindi Fatos Cani: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega' Hoteleri-Turizëm"
 11. Zaim Ramis Allko: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega "Mekanik"
 12. Anxhelo Jaho Rrumbullaku: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan Dega "Elekriçist".
 13. Mikel Ylli Cura: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan. Dega"Termohidraulik."
 14. Lorenc Rrapush Murati: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega":Mekanike."
 15. Marçelo Naim Carja: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega "Termohidraulik"
 16. Redion Iliaz Bogdani: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan Dega"Elektroteknik"
 17. Kasem Sami Terziu: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan Dega "Elektoteknik"
 18. Angiello Petro Kasa: Nxënës në Shkollën Profesionale Elbasan. Dega "Elektroteknik"
 19. Oresti Andon Xhani: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan.Dega "Tik"
 20. Nexhmije Xhevit Ferra: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan Dega' Hoteleri -Turizëm"
 21. Reinaldo Bujar Daka: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega"Elektriçist"
 22. Marjold Ilir Muzhaqi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan, Dega "Mekanik"
 23. Erdi Klodjan Topi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan Dega"Termohidraulik"
 24. Emiljano Guri Bardhi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Tiranë"Karl Gega", Dega"TIK"
 25. Aleks Arzen Allushi: Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Tiranë "Karl Gega, Dega Hoteleri-Turizëm.
 26. Lulzim Shefqet Qosja; Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale Elbasan. Dega Hoteleri -Turizëm
 27. Aurel Ferit Ushina; Nxënës në shkollën e Mesme Profesionale Elbasan Dega "Tik"
 28. Arlind Astrit Balla:Nxënës në Shkolla Mekanike-Buqesore "Hasan D. Gina", Lushnje. Dega Shërbime Mjetesh.
 29. Fabio Bujar Çepi:Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale"Elbasan"Dega"Tik"
 30. Mariglen Sadik Tusku:Nxënës në Shkollën e Mesme Profesionale:"Beqir Çela" Durrës Dega Elektroteknik".
 31. Emiljano Qani Stafa;Nxënës në shkollën e Mesme Profesionale "Charles Telford Erikson Dega Ekonomi.Golem Kavaje.
 32. Fabiola Sadik Toci: Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë:
1. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori i Arsimit Kulturës Sportit dhe Organizimit të Aktiviteteve.
 2. Ky vendim hyn ne fuqi dhjete dite pas shpalljes se tij.

KRYETARI BASHKISË

Mariglen Disha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD
AGJENSIA E FUNKSIONEVE TË PA TRANSFERUESHME
Spektori Arsimit Kulturës Sportit Rinisë dhe Organizimit të Aktiviteteve

RELACION

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me nr 13089/1 prot me datë 23.10.2024 ardhur tek ne me nr. 5169 prot atë 24.10.2024 .
Bashkisë Librazhd i janë akorduar 35 Bursa për klasat e 10 (dhjeta).
Kërkesat për bursa që kanë aplikuar në Bashkinë Librazhd janë 32.
Nga këto 22 trajtohen me ndihme ekonomike,4 trajtohen me pension invalidi
3, page minimale,1 pa të ardhura fare.1 është e komunitetit Egjiptjan.1 me biznes familjar(blektori)
Sipas shkollave profesionale vijojnë si më poshtë :

| | |
|--|-----------|
| Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela” Durres | 6 nxënës |
| Shkolla e Mesme Profesionale “Hysen Çela” Durres” | 1 nxënës |
| Shkolla e Mesme Profesionale “Gjergj Cano” Tiranë | 1 nxënës |
| Shkolla e Mesme Profesionale “Charles Teleford Erickson” | 2 nxënës |
| Shkolla e Mesme Profesionale “Elbasan” | 18 nxënës |
| Shkolla e Mesme Profesionale Tiranë “Karl Gega”, | 2 nxënës |
| Shkolla Mekanike-Buqesore “Hasan D. Gina”, Lushnje | 1 nxënës |
| Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë | 1 nxënës |

Nxënësja Fabiola Sadik Toci është në insitutin e nxënësve që nuk dëgjojnë dhe ne nuk e kemi në listën e shkollave profesionale,ju sugjerojmë që ta trajtoni me bursë,pasi numrin e bursave e kemi 35 vendimi i takon Këshillit Bashkiak.

Sipas kriterëve të përcaktuara në Nr.VKM 666 datë 10/10/2019 të gjithë aplikuesit përfitojnë bursa.

Duke ju falenderuar !

Konc :M.Çota

Miratoi :A.Karaj

P/Vendimi
V7 P = 10



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË
LIBRAZHD

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____/____/2024

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ,Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”. VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008,të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, proçedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik” Këshilli i Bashkisë Librazhd i mbledhur sot më datë ____/____/2024 pasi dëgjoi përfaqësuesit e bashkisë Librazhd mbi këtë projekt-vendim:

VENDOSI :

1. Të miratojë me shkrim vazhdimin e procedurave të mëtejshme të dhënies në përdorim të fondit pyjor e kullor publik për ushtrimin e veprimtarive për parqe fotovoltaike.
2. Sipërfaqja që kërkohet të jepet me qira është në pronësi të bashkisë Librazhd dhe bën pjesë në ngastrat nr. 4a,4b,24a të Ekonomisë Pyjore Vehçan me sipërfaqe totale 20 ha dhe çmimi fillestar në ankand do të jetë me vlerë **2 516 800 lekë** .
3. Proçedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Sekretari i Pergjithshem, Sektori Juridik, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik Bujqësisë dhe Turizmit, Drejtoria e Urbanistikës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

KRYETARI I BASHKISË
Mariglen DISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”.

VKM Nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”. VKM nr. 1374, datë 10.10.2008,të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.01 datë 09.06.2016 “Për rregullat,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”. VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar,

Bashkia Librazhd kërkon të jap në përdorim,për qëllime parqe fotovoltaike, për pjesë të ngastrave nr. 4a, 4b dhe 24a të Ekonomisë Pyjore Vehçan me sipërfaqe totale **20 ha** dhe me vlerë fillestare në ankand publik të hapur **2 516 800 lekë**.

Ky qëllim është i orientuar në politikat e qeverisë Shqiptare për rritjen e kapacitetit të fuqisë prodhuese të energjisë elektrike nga energjia e rinovueshme.

Impakti dhe të mirat që do të ketë realizimi i këtij projekti në sipërfaqen që bashkia kërkon që ta jap në përdorim janë si më poshtë :

1. Energjia e rinovueshme prodhon energji elektrike pa emetime. Prodhimi i një njësie të energjisë elektrike duke shfrytëzuar diellin, si në rastin e këtij projekti, nuk kërkon djegie të lëndëve djegëse dhe, si e tillë, shmang emetimet plotësisht. Edhe kur llogariten të gjithë ndikimet e ciklit jetësor të prodhimit, transportit, instalimit dhe çmontimit, energjia elektrike e gjeneruar nga panelet diellore ende rezulton në 96% më pak emetime sesa e njëjta njësi e energjisë elektrike e prodhuar nga termocentralet me djegie fosile.
2. Realizimi i këtij projekti synon të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis, në cilësinë e ujit dhe të ajrit, duke u kujdesur për ruajtjen dhe mos ndotjen e tokës dhe ambientit. Projekti fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike përdor teknologjinë e


fundit, në mënyrë të tillë që të mos ketë ndikime në mjedis. Në asnjë rast, qëllimi primar i përdorimit të tokës nuk do të ndryshohet në mënyrë të pa-rikthyeshme.

3. Të gjitha instalimet do të projektohen për tu instaluar në një sipërfaqe të konsiderueshme nga toka duke bërë të mundur që toka të mos i humbasë vetitë e saja. Po ashtu nga ana tjetër në impiant nuk do të ketë asnjë lloj shkarkimi, ndotje qoftë të lëngët, të gaztë apo të ngurtë.
4. Realizimi i këtij projekti në këtë objekt do të ndikojë në punësimin e banorëve të zonës.
5. Investimi do të ndikojë direkt edhe në buxhetin e bashkisë Librazhd për të cilën mund të themi që për **një afat 10 vjecar bashkia Librazhd do të arkëtojë minimumi 25 168 000 lekë**, një shifër e konsiderueshme kjo për një bashki të vogël.
6. Realizimi i këtij projekti nuk do të jetë pengesë për zhvillimin e zonës për veprimtari të tjera por do të ndikojë në zhvillimin e kësaj zone.

Sipërfaqja që do të jepet në përdorim është e formës së përdorimit tokë me bimësi pyjore ,djerr ,shkurre e llojit bush të tharë në mënyrë masive dhe inproduktive ose shkëmbore.Në këto sipërfaqe nuk ka studime ,plane zhvillimi si dhe investime të tjera afatgjatë.

Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak miratimin për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të këtyre sipërfaqeve të fondit pyjor të Bashkisë Librazhd në mënyrë që Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të vazhdojë procedurat e mëtejshme.

Jemi në pritje të miratimit nga ana J'uaaj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

| PRONARI/BASHKËPRONARËT | | |
|-------------------------|-------------------|------------|
| Emri i Personit Juridik | Nr. Personal NIPT | Pjesa(-/-) |
| BASHKIA LIBRAZHD | K57904611M | 1/1 |

| | | | |
|----------------------------|------------------------------------|-----------|-------------|
| Numri i Pasurisë | 714 | | |
| Kodi Unik | 1967009161 | | |
| Zona Kadastrale | 1967 | | |
| Lloji i Pasurisë | SHKEMBORE | | |
| Sipërfaqja e pasurisë (m2) | Totali: 292051 | Truall: 0 | Ndërtesë: 0 |
| Vlera Aktuale e Pasurisë | 1 | | |
| Adresa e Pasurisë | Librazhd, Librazhd, Rr.: Hotolisht | | |

DREJTORI
Mitat Biçaku



Vulosur elektronikisht nga Zyra
Vendore Librazhd
Date: 2023/12/04 08:31:42 +02'00'
K57904611M2023120408313610L1014

Trandafil
e

Digitally signed by
Trandafil Duka
Date: 2023.12.04
08:32:00 +02'00'

Silvana
Gjura

Digitally signed by
Silvana Gjura
Date: 2023.12.05
11:08:04 +02'00'

Mitat
Bicaku

04/12/2023
Digitally signed by
Mitat Biçaku
Date: 2023.12.05
11:41:34 +02'00'



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

| PRONARI/BASHKËPRONARËT | | |
|-------------------------|-------------------|------------|
| Emri i Personit Juridik | Nr. Personal NIPT | Pjesa(-/-) |
| BASHKIA LIBRAZHD | K57904611M | 1/1 |

| | | | |
|----------------------------|------------------------------------|-----------|-------------|
| Numri i Pasurisë | 715 | | |
| Kodi Unik | 1967009168 | | |
| Zona Kadastrale | 1967 | | |
| Lloji i Pasurisë | PYLL | | |
| Sipërfaqja e pasurisë (m2) | Totali: 709300 | Truall: 0 | Ndërtesë: 0 |
| Vlera Aktuale e Pasurisë | 1 | | |
| Adresa e Pasurisë | Librazhd, LIBRAZHD, Rr.: HOTOLISHT | | |

DREJTORI
Mitat Bıçaku



Vulosur elektronikisht nga Zyra
Vendore Librazhd
Date: 2024.11.11 13:35:43 +02'00'
K57904611M2024111113353606L1014

Shënim: Ky dokument është gjenuar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

Albana
Kurti

Digitally signed by:
Albana Kurti
Date: 2024.11.11
01:36:40 +02'00'

Erisa
Alikaj

Digitally signed by:
Erisa Alikaj
Date: 2024.11.11
02:07:09 +02'00'

Data e lemit
Bicaku

Digitally signed by:
Mitat Bıçaku
Date: 2024.11.11
02:17:45 +02'00'





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

Nr. 3842 Prot.

Librazhd, më 13 / 08 / 2024

AFISHIM PUBLIK

Për “ Dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor “

Në Njësinë Adminstrative Hotolisht

Bashkia Librazhd bazuar në ligjin 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore, ligjin 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet” ,VKM 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar me VKM 684 datë 02.09.2020 bashkia Librazhd ka në pronësi listën e inventarit sipas shtojcës 18,bazuar në udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” kërkon që të jap në përdorim sipërfaqet të cilat i ka të çertifikuara për veprimtaritë të parashikuar në lëggjislacionin në fuqi.

Bashkëngjitur gjendet harta e sipërfaqes që do të jepet në përdorim.

Pasi të jetë bërë afishimi publik i këtij njoftimi kërkojmë nga ana Juaj që të na përcillet çdo ankesë apo kërkesë të banorëve të kësaj njësie .

Faleminderit !

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen DISHA



NE MUNGESË DHE DELEGIM

Zv/Kryetari

Ermir SULOLLARI

P/Vendimi
№ = 11



REPUBLIKA E SHqipërisë
BASHKIA LIBRAZHË

№ 5568...Prot.

date: 12.11.2024

RELACION

PËR MIRATIMIN E "PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR 2025-2027" NË BASHKINË LIBRAZHË

Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që prekën strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin lokal dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Librazhd mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij sektori në territorin e saj. Pas një eksperience pune tetë vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat Bashkia Librazhd, ka punuar për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte.

Procesi i hartimit të Planit të Përmirësimit të shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Librazhd (në vijim referuar si Plani) është mbështetur nga Projekti "Bashki të Forta" i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Swiss Development & Cooperation) i zbatuar nga Helvetas, përmes asistencës teknike të ofruar nga Smart Processes shpk.

Qëllimi i planit është të përmirësojë cilësinë e arsimit parashkollor në Bashkinë Librazhd, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij. Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vendosjen e objektivave specifike për secilin proces dhe përcaktimin e treguesve të performancës për t'u përdorur për monitorim. Në pjesën e tretë, paraqitet buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren për rritjen e cilësisë së arsimit parashkollor.

Plani është shtrirë në të gjitha kopshtet nën juridiksionin e Bashkisë Librazhd dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Arsimit, Kurues dhe Turizmit, Sektori i Arsimit Parashkollor, me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore parashkollore për të gjithë fëmijët në këtë zonë.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Librazhd përqendrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve në kopshte dhe

vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë rritjen e regjistrimeve dhe frekuencimit në kopshte të vajzave dhe djemve, fuqizimin e strukturave të kopshteve dhe sigurimin e një shpërndarje të barabartë të fëmijëve. Në një periudhë tre vjeçare, Plani prezanton sfidat dhe mundësitë specifike të regjistrimit të fëmijëve, duke përfshirë nevojën për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave. Lista e aktiviteteve përfshin projekte si punësimi i specialistëve për arsimin parashkollor, vlerësimin e brendshëm kopshteve, themelinin dhe funksionalizimin e organizmave të institucionit arsimor si bordi i kopshtit, këshilli i prindërve, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin dhe prindërit për të përmirësuar shërbimin.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë Proceset Kryesore dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Librazhd. Qëllimi kryesor është të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i plotë për fëmijët në nevojë.

Për të arritur këtë qëllim, plani ka disa objektiva të përgjithshëm, si rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimi i procesit të menaxhimit të këtyre rasteve. Në mënyrë specifike, për të adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, plani synon të përmirësojë procesin e diagnostikimit të tyre dhe të sigurojë infrastrukturë të përshtatshme në kopshte për t'i bërë ata të aksesueshëm.

Në të njëjtën kohë, plani përfshin ndihmë të përditshme për të gjithë fëmijët në nevojë, përfshirë mbështetje ushqimore, trajtim psikologjik, si dhe ndërhyrje ligjore në rastet e nevojshme. Përveç kësaj, synohet edhe hartimi dhe zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes strukturave të shërbimit social të përfshira për të garantuar një trajtim të drejtë dhe të efektshëm për të gjithë fëmijët në nevojë.

Planifikimi dhe zbatimi i Proceseve Mbështetëse në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Librazhd është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve dhe sigurimin e materialeve didaktike. Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është të ofrojë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët.

Për të arritur këtë qëllim, objektivat kryesore përfshijnë plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji për stafin e kopshteve, rikonstruksionin e godinave të kopshteve për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurimin e materialeve didaktike për të përmbushur nevojat e zhvillimit të fëmijëve. Në procesin e rekrutimit të stafit, janë parashikuar veprime specifike si punësimi i drejtorëve të kopshteve për të përmbushur standardin e një drejtori për çdo 5 grupe fëmijësh, duke respektuar udhëzimet ligjore. Gjithashtu, është parashikuar trajnimi i stafit për situata emergjente dhe për përdorimin e teknologjisë së informacionit, nëpërmjet bashkëpunimit me agjencitë përkatëse për sigurimin e trajnimeve të nevojshme. Për rikonstruksionin e godinave, janë identifikuar nevojat konkrete të kopshteve, duke përfshirë rikonstruksionin e tualeteve, rinovimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, si dhe sigurimin e materialeve të nevojshme për këtë qëllim. Në planifikimin e nevojave për materiale, është parashikuar

hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar një standard të përshtatshëm për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në kopshte.

Këto masa synojnë të sigurojnë një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe cilësor për të gjithë fëmijët, vajza e djem, duke përbushur nevojat e tyre të edukimit dhe zhvillimit në mënyrë efektive.

Zbatimi i Planit do të kërkojë buxhet shtesë të nevojshëm për të realizuar të gjitha projektet e përfshira në Planin e Përmirësimit të Shërbimit. Buxheti shtesë përfshin fusha të ndryshme, duke përfshirë arsimin bazë dhe arsimin parashkollor, si dhe programe për kujdesin social të familjeve, fëmijëve dhe personave të sëmurë apo me aftësi të kufizuara, të parashikuara në PBA 2025-2027.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, paraqesim projekt vendimin për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në bashkinë Librazhd.

KRYETAR

Erigen DËSHA



Agjensia e Funksionimit të Patranferueshem

Sektori i Arsimit, Kultures, Rinise, Sporteve dhe Organizimit të Aktiviteteve Festive
Marsida ÇOTA

Marsida Çota
(Emër, Mbiemër, firmë)

Sekretari i Përgjithshëm
Bajram PISHKASHI

Bajram Pishkashi
(Emër, Mbiemër, firmë)

NenKryetar
Ermir SULOLLARI

Ermir Sulollari
(Emër, Mbiemër, firmë)